

Konsultim publik për Planin vendor të veprimit për barazinë gjinore, 2026-2028.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Edison Memolla.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të Bashkisë Rrogozhinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Planin vendor të veprimit për barazinë gjinore, 2026-2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Bashkinë Rrogozhinë , sipas kalendarit më poshtë:

Rrogozhinë

Data	Ora	Vendi
23.01.2026	10.00	Salla e mbledhjeve ne bashki

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura, në adresat e emaille ledio-hasani@hotmail.com

Linku i dokumentit:

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, administrata e bashkisë
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Rrogozhinë, organizata joqeveritare dhe shoqëri civile.

Forma e konsultimit: Takim publik.

Qëllimi i këshillimit publik

Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve sa i takon Planit vendor të veprimit për barazinë gjinore, 2026-2029.

Përshkrimi i çështjes

Plani synon të sigurojë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme për promovimin e barazisë gjinore në nivel vendor, duke garantuar pjesëmarrje të barabartë

të grave dhe burrave në vendimmarrje, përmirësim të qasjes së grave në shërbime dhe mundësi ekonomike, si dhe mbrojtje të të drejtave të tyre.

Objektivat e Planit:

1. **Hartimi i një kuadri strategjik lokal** që përcakton prioritetet për promovimin e barazisë gjinore në Bashkinë Rrogozhinë për periudhën 2026–2028.
2. **Identifikimi i fushave prioritare të ndërhyrjes** për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke përfshirë pjesëmarrjen në vendimmarrje, mundësitë ekonomike dhe përfshirjen sociale.
3. **Përcaktimi i objektivave specifike, treguesve dhe rezultateve të matshme** për monitorimin dhe raportimin e progresit.
4. **Sigurimi i një mekanizmi bashkëpunimi dhe koordinimi** ndërmjet bashkisë, këshillit bashkiak, institucioneve arsimore, OJF-ve dhe komunitetit.
5. **Përfshirja e masave konkrete dhe të zbatueshme**, duke marrë parasysh buxhetin e kufizuar të bashkisë dhe mundësinë e mobilizimit të mbështetjes nga partnerë dhe donatorë.

Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;

Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit: ledio-hasani@hotmail.com

BRENDA DATËS 23.01.2026 - 30.01.2026

Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Rrogozhine do të ndjekë hapat si vijon:

1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit ose personave përgjegjës në bashki të një Përmbledhjeje të

Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli dhe administrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit

Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;

2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Barazisë Gjinore, të Ekonomisë dhe Financës, ve dhe çdo këshilltari të bashkisë;

3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve të cdo rekomandimi dhe opinionit.

4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit.

5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar.

6. Monitorimi i zbatimit të tij.

Data e publikimit

06.01.2026